Kronikë

Tentativa e vetëvrasjes në Vlorë, gjendet pistoleta me të cilën 17-vjeçarja qëlloi veten në shtëpinë e gjyshërve

Pistoleta u gjet brenda një qeseje dhe ishte hedhur mes në grumbulli materialesh të ndryshme shtëpiake pranë banesës së gjyshërve të 17-vjeçares.

■ Vajza tentoi vetëvrasjen me armë, Gjykata e Vlorës lë në burg babain e 17-vjeçares

Foto: Pistoleta e zbuluar brenda një qeseje

Redaksia
17 Korrik, 14:55 | **Përditesimi: 17 Korrik, 15:04**

Share

Tre ditë pas ngjarjes së rëndë në Vlorë ku një 17-vjeçare tentoi vetëvrasjen, uniformat blu kanë gjetur armën e zjarrit tip pistoletë.

Arma dyshohet se është përdorur nga 17-vjeçarja, me të cilën qëlloi veten në kokë, duke mbetur e plagosur.

Pistoleta u gjet brenda një qeseje dhe ishte hedhur mes një grumbulli materialesh të ndryshme shtëpiake pranë banesës së gjyshërve të 17-vjeçares.

LEXO EDHE:
2 të rinjtë qëllohen me armë në Sarandë, dërgohen te Trauma! Në kërkim 2 vëllezërit, gjendet çanta me pistoletë (EMRAT+VIDEO)

Krimi ndodhi në shtëpinë e gjyshërve të adoleshentes, e për këtë arsye, gjyshi i 17-vjeçares është nën hetim në gjendje të lirë për armëmbajtje pa leje.

Po kështu, sipas policisë, arma ishte fshehur nga familjarët e vajzës pas ngjarjes së rëndë.

Ndërsa babai i 17-vjeçares është arrestuar dhe sot u la në "arrest në burg" nga Gjykata e Vlorës, për dhunë në familje. Kjo pasi dyshohet se vajza e ndërmorri aktin ekstrem pas dhunës nga babai dhe konflikteve të vazhdueshme me të.

Sa i përket 17-vjeçares, ajo ndodhet në Spitalin e Traumës në Tiranë në gjendje të rëndë.

Njoftimi i Policisë Vlorë:

Vlorë/Gjendet dhe sekuestrohet arma e zjarrit që dyshohet se u përdor nga 17-vjeçarja në tentativën për vetëvrasje.

Në vijim të hetimeve për ngjarjen e ndodhur më datë 14.07.2025, në lagjen "Kushtrimi", ku një 17-vjeçare mbeti e plagosur rëndë pas tentativës për vetëvrasje me armë zjarri, u bë e mundur gjetja dhe sekuestrimi, në cilësinë e provës materiale, i armës së zjarrit pistoletë, e cila ishte hedhur në një vend grumbullimi materialesh të ndryshme shtëpiake, pranë banesës së gjyshërve të të mituës dhe ndodhej brenda një qeseje plastike.

Arma e sekuestruar do t'i dërgohet Institutit të Policisë Shkencore për ekzaminime të mëtejshme, me qëllim dokumentimin e plotë të ngjarjes.

Materialet shtesë iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për veprime të mëtejshme.

V.GJ /Shqiptarja.com

TAG: tentativa e vetevrasjes ne vlore | pistoleta | Vlore

Komentoj

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 16 Korrik, 19:55

Përplasja mes Lapajt e Shabanit për mandatin, kush mendoni se ka të drejtë?

Adriatik Lapaj | Endri Shabani | Nuk e di

Lajme të tjera

Sarandë/ 26-vjeçari qëllon me thikë ish-kunatin pas një sherri, arrestohet
17 Korrik, 11:55



Vajza tentoi vetëvrasjen me armë, Gjykata e Vlorës lë në burg babain e 17-vjeçares
Armand Xhelili
17 Korrik, 10:35

Lirimi i hapësirave publike në Sarandë, prishet kioska e kthyer në Fast Food
17 Korrik, 10:03

VKM/ Qeveria miraton vendimin, hapet pika e kalimit kufitar në Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës
16 Korrik, 19:14

Vdekja e 7-vjeçares në Himarë pasi u përplas nga skafi, Gjykata e Vlorës shpall të pafajshëm 8 efektivët e akuzuar për shpërdorim detyre
Armand Xhelili
16 Korrik, 16:43

Taksia përplaset me biçikletën në Vlorë! Pas aksidentit grushte dhe shkelma, një amerikan përfundon në spital
16 Korrik, 07:12

Lirimi i hapësirave publike, Ndreu: Në Tiranë, lokali i parë që u çmontua ishte i vëllait tim! Aksioni në Theth mund të kryhej pas sezonit turistik
15 Korrik, 19:46

U vetëplagos me armë në kokë, e mitura s'donte të kthehej në fshat te njerka
Armand Xhelili
15 Korrik, 14:50

Pallati në Vlorë u konfiskua se ishte pa leje, në hetim për ndërtim të paligjshëm administratori dhe investitori
15 Korrik, 13:46

Punonjësit e Policisë së Vlorës dhurojnë gjak për fëmijët e prekur nga Talasemia
15 Korrik, 13:31

'Janë të aftë, nuk i heq', kryebashkiaku i Konispolit 'refuzon' urdhrin e Ramës, kryeministri: Atëherë jep dorëheqjen
15 Korrik, 12:22

Vlorë/ Policia vijon aksionin për lirimin e hapësirave publike nga parkimet e gabuara! 576 gjoba gjatë tri ditëve
15 Korrik, 11:16

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje